



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2023

LËNDA: FILOZOFI DHE SOCIOLOGJI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30	31	32
Pikët								
Kërkesa	33	34	35	36				
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2. ....Anëtar

## Sociologji

1. Në shoqërinë tradicionale shqiptare, respektimi i besës bëhej i mundur në saj të bashkëndimit të dy faktorëve: **1 pikë**
  - A) zakonit dhe traditës në vend
  - B) forcës së opinionit dhe hyjnizimit të saj
  - C) detyrimit ligjor dhe sanksioneve shoqërore
  - D) opinionit dhe veprimit të strukturave shtetërore
  
2. "Shok kulturor" është termi sociologjik që përdoret për të: **1 pikë**
  - A) treguar afrimitetin me një kulturë tjetër
  - B) treguar mbivlerësim për një kulturë tjetër
  - C) shprehur befasimin nga një kulturë tjetër
  - D) shprehur nënvlerësimin për një kulturë tjetër
  
3. Cili nga vlerësimet kulturore, krijon kushtet më të favorshme për një fqinjësi të mirë ndëretnike? **1 pikë**
  - A) Ksenofobia
  - B) Etnocentrizimi
  - C) Ksenocentrizmi
  - D) Relativizmi kulturor
  
4. Romët në Shqipëri përbëjnë një: **1 pikë**
  - A) pakicë etnike
  - B) pakicë fetare
  - C) pakicë kombëtare
  - D) grupim kaukazian
  
5. Në sociologji ndryshimi shoqëror: **1 pikë**
  - A) është efektiv dhe vetëm me rrjedhoja pozitive
  - B) është i përcaktuar të ndodh sipas planifikimit
  - C) është i përgjithshëm dhe me veçori dalluese
  - D) sjell vetëm problematika dhe efekte negative
  
6. Procesi i shpërqendrimit urban lidhet me faktorin e: **1 pikë**
  - A) rritjes së shkallës së kriminalitetit
  - B) rritjes së çmimeve në zonat e qendrës
  - C) uljes së çmimeve në zonat e periferisë
  - D) uljes së aktiviteteve të jetës sociale në qendër
  
7. Procesi i shekullarizimit në sociologji nënkupton: **1 pikë**
  - A) ruajtjen e formave më tradicionale të besimeve fetare
  - B) dobësimin e rolit të besimeve fetare në jetën e shoqërisë
  - C) zbehjen e rolit të shkencës bazuar në mungesën e arsytimit
  - D) bashkëpunimin e organizatave fetare me strukturat shtetërore

8. Thashethemet janë të rëndësishme për krijimin e opinionit publik në shoqërinë: **1 pikë**

- A) moderne
- B) tradicionale
- C) pasmoderne
- D) perëndimore

9. Besimi se përparimet shkencore përmirësojnë jetën, është vënë në diskutim nga kritikët e shoqërisë: **1 pikë**

- A) moderne
- B) së kastave
- C) tradicionale
- D) pasmoderne

10. Në sociologji analiza krahasuese konsiderohet: **1 pikë**

- A) mangësi e anketës sociologjike
- B) përparësi e anketës sociologjike
- C) përparësi e vëzhgimit josistematik
- D) mangësi për studimet sociologjike

11. Shpjegoni konceptet sociologjike të poshtëshënuara: **2 pikë**

Nënkulturë: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Kundërkulturë: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

12. Familja dhe shkolla janë dy agjencitë shoqërizuese me më shumë ndikim. Analizoni rolin e tyre. **2 pikë**

Familja \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Shkolla \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

13. Kuptimi i sjelljeve deviante ndryshon në varësi të disa kushteve. Shpjegoni tre faktorë që ndikojnë në karakterin relativ të deviancës. **3 pikë**

1) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

14.Përcaktoni formën e martesës për secilin rast: **3 pikë**

Gruaja ka të drejtë të ketë lidhje martesore në të njëjtën kohë me dy ose më shumë burra. \_\_\_\_\_

Burri ka të drejtë të ketë lidhje martesore me më shumë se një grua në të njëjtën kohë. \_\_\_\_\_

Model martese ndërmjet një burri dhe një gruaje që i përkasin të njëjtit grup shoqëror. \_\_\_\_\_

15.Shpjegoni dy cilësitë kryesore të grupeve shoqërore të pakicave. **2 pikë**

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

16.Shpjegoni nga një karakteristike për dy fetë botërore të poshtëshënuara. **2 pikë**

Krishterimi \_\_\_\_\_

Islamizmi \_\_\_\_\_

17.Mënyra e jetesës në fshat dallon nga mënyra e jetesës në qytet. Analizoni dy karakteristika të mënyrës së organizimit shoqëror të bashkësisë, sipas sociologut Tënis. **2 pikë**

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

18.Sociologu Frederik Miler ka analizuar arsyet për rënien e lëvizjeve shoqërore. Argumentoni dy prej tyre. **2 pikë**

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

19.Shpjegoni dy karakteristika për intervistat e gjysmëstrukturuara. **2 pikë**

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

**Filozofi**

20. Mark Aureli trajtoi me përparësi filozofinë: 1 pikë

- A) cinike
- B) skeptike
- C) politike
- D) teologjike

21. Për të shpjeguar zanafillën e botës, Plotini niset nga: 1 pikë

- A) Njëshi
- B) materia
- C) mitologjia
- D) zotat e qytetit

22. Në periudhën e Mesjetës përgjigjet e pyetjeve ekzistenciale ishin monopol i: 1 pikë

- A) kishës
- B) filozofëve
- C) shkencës
- D) mitologjisë

23. Për Shën Agustinin shpirti ka natyrë: 1 pikë

- A) materiale
- B) jomateriale
- C) të fundme
- D) lëndore

24. Lëvizja intelektuale e shekullit XVIII është: 1 pikë

- A) iluminizmi
- B) materializmi
- C) obskurantizmi
- D) ekzistencializmi

25. Për Hjumën, ato dukuri që krijohen nga ndijimet e para mbi sendet që ai i quan ndjesi, emocione, pasione, lidhen me: 1 pikë

- A) idetë
- B) mbresat
- C) arsyetimin
- D) refleksionin

26. Në veprën: "Traktat mbi tolerancën", Volteri shfaqet: 1 pikë

- A) si përkrahës i obskurantizmit
- B) respektues fanatik i dogmës fetare
- C) si mbështetës i kishës dhe ritualeve fetare

D) kundër paragjytimeve dhe dogmave fetare

27. Hermeneutika është një drejtim i ri në filozofinë moderne, synimi kryesor i së cilës është: **1 pikë**

- A) të huazojë
- B) të kritikojë
- C) të interpretojë
- D) të eksperimentojë

28. Sipas Hajdegerit njeriu ndjen ankth kur: **1 pikë**

- A) merret me dogmën fetare
- B) nuk trajton me përparësi ritualet fetare
- C) nuk trajton me përparësi aspektet filozofike
- D) dasein zbulon dramën e kotësisë së qëllimeve të tij

29. Pyetja: "Çfarë është me të vërtetë e dobishme për njeriun?" është karakteristike për drejtimin: **1 pikë**

- A) dialektik
- B) pozitivist
- C) utilitarist
- D) strukturalist

30. Platoni e ndau realitetin në dy pjesë, përcaktojini ato. **2 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_

31. Aristoteli trajtoi idenë e motorit të parë, që vë në lëvizje gjithçka. Shpjegoni tri tipare të tij. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_

32. Bazuar tek skeptikët, shpjegoni tri rrugë që i ndihmojnë njerëzit për të arritur qetësinë shpirtërore. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

33. Akuini i ndikuar nga filozofia e Aristotelit, e përshtati atë në funksion të krishterimit. Shpjegoni tri drejtimet ku shfaqet ky ndikim. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

34. Vlerësoni: **3 pikë**

Racionalizmi mbështetet mbi parimin se dija është rezultat i arsytimit: \_\_\_\_\_.

Dija njerëzore vjen si rezultat i përvojës, bazuar në rrymën filozofike të: \_\_\_\_\_.

Bekon fillonte me njohjen e fenomenit natyror dhe më pas kalonte në një sërë hapash të ndërmjetëm, për të arritur në aksiomat e përgjithshme mbi natyrën, kjo është metoda: \_\_\_\_\_.

35. Argumentoni sipas Kantit: **3 pikë**  
Çfarë do të thotë sipas Kantit të veprash me vullnet?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Cili është raporti ligj-liri sipas Kantit?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Si shfaqet Kanti në raport me besimin në Zot?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

36. Shpjegoni tri tezat themelore mbi të cilat u mbështet strukturalizmi i Klod Levi Stros. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

3)

---

---